



RAPID

Llaç lidhës i shpejtë

VETITË DHE FUSHA E PËRDORIMIT

Hydrobloker Rapid është përzierje e gatshme me bazë të çimentos aluminate dhe shtesave të veçanta kimike për arritjen e punueshmërisë së mirë, lidhjes së shpejtë, ngjitjes, fortësisë së lartë fillestare dhe papërshkueshmërisë nga uji.

Përdoret për mbylljen e depërtimit të ujit dhe për punime sanuese ku kërkohet arritje e shpejtë e fortësisë: sanimin e sipërfaqeve të vogla në të cilat kalohet, hapjeve, ankorimeve, rrjedhjeve, instalimin e kornizave të dritareve, kornizave të dyerve, etj., në temperatura normale e para së gjithash në temperatura të ulëta.

UDHËZIME PËR PËRDORIM

• PËRGATITJA E BAZËS

Sipërfaqet mbi të cilat e vendosim **Hydrobloker Rapid**, duhet të jenë të forta, të pastruara nga pluhuri, njollat e vajrave/lyrave, mbetjeve të korrozionit, mykut dhe papastërtive tjera. Pjesët e lidhura dobët ose mbetjet nga lyerjet paraprake duhet t'i heqim me brushë, gërryerje ose vrushkull rëre. Sipërfaqet e thata duhet që para vendosjes së llaçit t'i njomim shumë mirë me ujë.

• PËRGATITJA E LLAÇIT

Përzierjes së thatë të Hydrobloker Rapid i shtojmë ujë, në mënyrë intensive dhe të shpejtë deri në punueshmërinë e duhur: 0,20 - 0,25 l ujë në 1 kg llaç:

- Për mbylljen e depërtimit të ujit: ca. 0,20 l/kg llaç

- Për punë sanuese dhe ankorime: ca. 0,25 l/kg llaç.

Përgatisim vetëm atë sasi të llaçit të cilën mund ta harxhojmë brenda intervalit kohor afërsisht 3 minuta.

Paralajmërim:

Hydrobloker Rapid lidhet për afërsisht për 1-3 minuta në temperaturë 20°C. Koha e lidhjes në temperatura të larta shkurtohet, kurse koha e lidhjes zgjatet në temperatura të ulëta. Për këtë arsye sipas nevojës e rregullojmë me ftohjen, respektivisht ngrohjen e ujit të përdorur për përgatitjen e masës. Në kohën e lidhjes dhe rritjen e fortësisë fillestare ndikon sasia e ujit të përzierjes dhe temperatura e ajrit. Kur **Hydrobloker Rapid** fillon lidhjen nuk guxohet më të formësohet/punohet!

• VENDOSJA E LLAÇIT

Sanime të vogla, fiksime, ankorime:

Llaçin e vendosim me mjete dore të rëndomta muratorie ose me dorë (patjetër përdoren dorezat mbrojtëse). Llaçin duhet ta punojmë shpejt dhe ta shtypim fort në bazë.

Mbyllja e depërtimeve të vogla të ujit:

Plasuritjet, segregimet, etj., nëpër të cilat depërton uji, duhet që t'i hapim (presim) së paku në thellësi 2 cm dhe gjerësi 2 cm në formë drejtëkëndëshe ose, edhe më mirë në formë të bishtit të dallëndyshes, por kurrë në formë të shkronjës V. Nga llaçi i përgatitur e formojmë bllokuesin (kunjin-pykën), të cilin e mbajmë në dorë për aq kohë sa nuk fillon të nxehet. Atëherë e shtypim me forcë në vendin e parapërgatitur të cilin dëshirojmë ta mbyllim dhe e mbajmë ashtu për disa minuta, derisa llaçi lidhet-kunji bëhet i fortë.

**HydroBlocker****RAPID****Брзоврзувачки малтер****• TRAJTIMI I LLAÇIT TË NJOMË**

Sipas nevojës llaçin e punuar/vendosur e njomim afërsisht 15 - 30 minuta (temperatura të larta, bazat/sipërfqet absorbuese, era, sasia më e madhe e llaçit, etj.)

• PASTRIMI I MJETEVE DHE PAJISJEVE NDIHMËSE

Të gjitha mjetet dhe pajisjet ndihmëse duhet, që pas punës, t'i pastrojmë shumë mirë me ujë.

KONSUMI

1,7 kg/m²/mm respektivisht 1,7 kg e llaçit të thatë për 1 litër llaç të njomë

AMBALAZHIMI

• thasë 25 kg, kovë 5 kg, kovë 1 kg

MAGAZINIMI

- Produktin duhet ta ruajmë në ambalazh të mbyllur mirë, në vend të thatë dhe të ajrosur, të mbrojtur nga dëmtimi dhe lagështia.
- Në ambalazh të mbyllur mirë, të padëmtuar, të vendosur në mjedis të thatë, afati i përdorimit është min.12 muaj nga data e prodhimit.
- Pas skadimit të datës së përdorimit produkti nuk është domosdoshmërisht i papërdorshëm, veçse duhet të testohen ato veti të cilat janë të rëndësishme për përdorimin e caktuar.

PARALAJMËRIME SIGURIE

Për shkak të përmbajtjes së çimentos shkakton irritim të lëkurës, kështu që në kontakt me lëkurën mund të shkaktojë reaksione alergjike. Për këtë arsye, gjatë punës me llaç duhet t'i përdorim dorezat mbrojtëse, si dhe të parandalojmë kontaktin në sy (duhet përdorur syzat mbrojtëse). Gjithashtu duhet të shmangim thithjen me frymëmarrje të pluhurit. Gjatë punimeve të gjata me llaç duhet përdorur pajisje për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes.

VËREJTJE

Udhëzimet janë dhënë në bazë të hulumtimeve dhe përvojës tonë, por për shkak të kushteve specifike dhe mënyrës së punimeve rekomandojmë testime paraprake për secilin rast të veçantë të përdorimit. Pasi që nuk mund të ndikojmë në kryerjen e punimeve, nuk mbajmë përgjegjësi për cilësinë e tyre!

Informata teknike (08/17)